



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Driton Sylejmani

Nr.Prot.:1986/18, Datë:22.08.2018

Në bazë të nenit 10 të Rregullores për Zgjedhjet Studentore të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Këshilli Drejtues (KD) i UShAF në mbledhjen e mbajtur me datën 22.08.2018, mori:

V E N D I M

I. Shpallen zgjedhjet e studentëve të UShAF, të cilat do të mbahen me 18.09.2018

1. Komisioni Qendror Zgjedhor do të konstituohet nga kryesuesi i KD brenda pesë ditëve nga dita e shpalljes.
2. Të gjitha organizatat studentore, të cilat do të marrin pjesë në zgjedhjet studentore në vitin 2018 duhet të jenë të regjistruar në Ministrinë e Administratës Publike dhe të konfirmuara nga Komisioni Qendror Zgjedhor.
3. Në zgjedhjet studentore mund të marrin pjesë organizatat të cilat janë regjistruar 15 ditë para datës së zgjedhjeve respektivisht deri më 03.09.2018.
4. Zgjedhjet studentore për Parlamentin Studentor do të zhvillohen në pajtim me Rregulloren për Zgjedhjet Studentore të miratuar nga Këshilli Drejtues.

II. Vendimi shpallet në web faqen e UShAF dhe Tabelën e shpalljeve të UShAF

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Driton SYLEJMANI


